



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

S- 051

Prishtinë, më 15 dhjetor 2008, në orën 14:45

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

P R O C E S V E R B A L

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
15 DHJETOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Ibrahim Gashi**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 90 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari njoftoi deputetët se në bazë të Vendimit të Kuvendit të Kosovës për shmangie nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të identifikuara në Propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës dhe të legjislacionit lidhur me të, sipas procedurës së veçantë, datë 15 shkurt 2008, seanca e sotme plenare do të zhvillojë punimet me këtë

R e n d d i t e:

I. Shqyrtimi i parë i Grupit të tetë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt;
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi;
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës;
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës;
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatieke dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të huajt

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, në emër të Qeverisë, e prezantoi Projektligjin për të huajt dhe i propozoi Kuvendit që ta miratojë, në parim.

Pasi që askush nga grupet parlamentare nuk u paraqit për fjalë, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 86,
Kundër----- 4,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për të huajt.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Shëndetësisë, Alush Gashi, në emër të Qeverisë, e prezantoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi dhe i propozoi Kuvendit që ta miratojë, në parim.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Makolli**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, të cilat janë dhënë në transkript, i cili është pjesë përbërëse e këtij procesverballi.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 52,
Kundër----- 17,
Abstenime-----17.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shëndetësi.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Shërbimeve Publike, Arsim Bajrami, në emër të Qeverisë, e prezantoi Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe i propozoi Kuvendit që ta miratojë, në parim.

Pasi që askush nga grupet parlamentare nuk u paraqit për fjalë, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 77,
Kundër----- 4,
Abstenime-----6.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja e Drejtësisë, Nekibe Kelmendi, në emër të Qeverisë, e prezantoi Projektligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës dhe i propozoi Kuvendit që ta miratojë, në parim.

Pasi që askush nga grupet parlamentare nuk u paraqit për fjalë, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 75,
Kundër----- 5,
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për përbërjen e përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, në emër të Qeverisë, e prezantoi Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës dhe i propozoi Kuvendit që ta miratojë, në parim.

Pasi që askush nga grupet parlamentare nuk u paraqit për fjalë, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 78,
Kundër----- 3,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që ta prezantojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, në emër të Qeverisë, e prezantoi Projektligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës dhe i propozoi Kuvendit që ta miratojë, në parim.

Pasi që askush nga grupet parlamentare nuk u paraqit për fjalë, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 82,
Kundër----- 2,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për Shërbimin Konsullor të Misioneve Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Ad-hoc që në bazë të Vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, ta shqyrtojë këtë projektligj dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale